



REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT MJEDISOR

Nr. 613 Prot.

Tiranë, më: 23 / 1 . 2019

Nr. Identifikimi 35

Vendimi 02

REFUZIM DEKLARATE MJEDISORE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore, dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri

VENDOSI :

Mos paisjen me Deklaratë Mjedisore për **Zhvilluesin** me të dhënat si më poshtë:

Personi juridik: “HAZISLLARI” sh.p.k.
Nr. NIPT-i: L78607001D
Adresa e selisë: Objekti Leskovik, zona minerare Nr. 322, rruga Leskovik - Ersekë, Km.15, Leskovik, Korçë
Personi përgjegjës: Aranit Hazisllari

Për të zhvilluar projektin “**Shfrytëzim i minerlit gëlqerorit të mermerizuar**” Aplikimi është bërë referuar ligjit Nr. 10 440, datë 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, Shtojca I, “Projektet që i nënshtrohen Procedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis”, Pika 19. Gurore dhe miniera sipërfaqësore, ku sipërfaqja e vendit është mbi 0,5 hektarë, ose vende për nxjerrjen e torfës, ku sipërfaqja e vendit është mbi 1 hektar.

Vendndodhja: Objekti Leskovik, Qarku Korçë.

(Bashkangjitur Anex 1 Harta dhe koordinatat)

Bazuar në pikën 2 të nenit 12 të ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, më poshtë po listojmë:

1. Qëndrimin e Drejtorive Teknike:

- Drejtoritë teknike të ministrisë shprehin mendimin si më poshtë vijon: Në raportin e thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis të reflektohet legjislacioni në fushën e mbetjeve;
- Të mbahen parasysh kërkesat e nenit 38, ligjit nr. 10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë”;
- Mbetjet inerte që do të gjenerohen të trajtohen sipas kërkesave të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”;
- Mbetjet që do të krijohen të specifikohen sipas kodit të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 99, datë 18.2.2005, “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve” të ndryshuar;
- Informacion mbi vajrat e përdorura të makinerive, të cilat klasifikohen si mbetje të rrezikshme. Të trajtohen sipas kërkesave të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 765, datë 07.11. 2012 “Për rregullat dhe procedurat për asgjësimin e vajrave të përdorur”;
- Informacion mbi bateritë e automjeteve, që klasifikohen si mbetje jashtë përdorimit dhe të rrezikshme. Të trajtohen sipas kërkesave të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 866, datë 4.12.2012 “Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre”;
- Subjekti që do të transportojë apo transferojë mbetjet të jetë i pajisur me licencë të tipit III.2.B, si detyrim i nenit 57, të ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” të ndryshuar,
- Të respektohen kërkesat e VKM nr. 247, datë 30.4.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”;

Të jepet informacion i zgjeruar në raport, rreth:

- a. sasisë së gjenerimit të mbetjeve,
 - b. trajtimit të mbetjeve;
 - c. transportimit të mbetjeve dhe
 - d. asgjësimit të mbetjeve, sipas kërkesave e akteve të sipërcituar dhe akteve të tjera ligjore në fuqi;
- Rekomandojmë mbajtjen parasysh të referencave ndaj ligjit të pyjeve dhe të dhënave kadastrale për pyjet dhe kullotat;
 - Në raportin e thelluar të VNM-së të reflektohet legjislacioni në fushën e ajrit si: Ligji nr. 10266 datë 15.04.2010 “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja”, i cili amendon ligjin nr. 8897 datë 16.05.2002 “Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja” dhe VKM-së nr.435 datë 12.09.2015 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu, subjekti duhet të hartojë një plan masash paraprake për të ulur shkarkimet në ajër.
 - Sugjerojmë që të merret mendimi i Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.
 - Raporti i thelluar duhet të strukturohet dhe të përmbajë të gjithë informacionin e kërkuar në shkojcën II të VKM nr. 686/2015.

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura shprehet: sipërfaqja ku do të ushtrohet aktiviteti ndodhet jashtë zonave të mbrojtura dhe nuk prek Monumente Natyre.

2. Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi:

Lidhur me këtë aplikim, janë kryer 2 dëgjesa me publikun e zonës përreth, bazuar në:

- VKM Nr. 247 date 30.04.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimarrjen mjedisore”, KREU I, INFORMIMI I PUBLIKUT GJATË PROCEDURËS SË THELLUAR TË VNM-SË
- Konventës se Aarhusit e ratifikuar në vitin 1998, pjesë e së cilës është edhe Republika e Shqipërisë dhe bazohet në:
 - Rëndësinë e informimit dhe përfshirjen e publikut në vendimarrjen mjedisore
 - E drejta e publikut për të patur e për të kërkuar informacion mjedisor
 - E drejta e publikut për të marrë pjesë në vendimarrjet publike për çështje të mjedisit
 - E drejta e publikut për t’u ankuar në gjykatë për çështje të mjedisit

Në të dyja dëgjesat, pjesëmarrësit janë shprehur kundër këtij instalimi, duke qënë se rreth kësaj zone, banorët kryejnë aktivitete të tilla si agroturizëm familjar, bujqësi, blegtori etj.

Zbatimi i këtij projekti ndikon negativisht në zhvillimin e aktiviteteve sa më sipër.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I AKM

EDISON KONOMI

MINISTRI

BLENDI KLOSI

1. Anex 1. Harta dhe koordinatat

Leja Minerare Nr...(zona322)

